

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Albert Zogaj dhe Nora Bllaca-Dula anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H.K. nga fshati ... Komuna e Hanit te Elezit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z.I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Insig" me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.H. dhe Fondit të Garancisë së Kosovës-tani BKS me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.S. me autorizim për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.120/14 të datës 24.09.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt.06.09.2017 mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "Insig" me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.120/14 i datës 24.09.2014, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në paragrafin I të dispozitivit, miratohet në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditësit H.B. (duhet të jetë K.) nga fshati ... Komuna e Hanit te Elezit dhe detyrohet e paditura KS "Insig" me seli në Prishtinë, që paditësit të ia paguaj shumën prej 2.709.00 €, në emër të dëmit material me kamatë në lartësi si për mjetet e deponuara në bankë në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar, duke filluar prej datës 26.04.2010 e deri në pagesën definitive. Në paragrafin II të dispozitivit, padia e paditësit H.K. nga fshati ... Komuna e Hanit te Elezit, e ushtruar me datën 27.07.2014 kundër të paditurës Fondit të Garancisë së Kosovës-tani BKS, pranohet si e tërhequr. Me të njëjtin aktgjykim në paragrafin III të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit shumën e gjykuar në pikën një dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 666 € t'ia paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrje së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor ka paraqit ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësi me padi dhe përmes të autorizuarit të tij gjatë shqyrtimit kryesor ka theksuar se ka kërkuar aprovimin e kërkesë padisë dhe që gjykata t'i detyroi të paditurat që paditësit në mënyrë solidare të ja paguajë shumën prej 2.709,00 €, në emër të dëmit material për automjetin e dëmtuar, dëm i cili është shkaktuar me fajin e saj dhe me përgjegjësin e të paditurave. Bazuar në ekspertizën e komunikacionit të ekspertit Y.K. dhe ekspertizën plotësuese është konstatuar se përgjegjësin kryesore në këtë rast e ka e paditura KS “Insig” dhe atë 70 %, ndërsa automjeti “Pikapi” ka përgjegjësi prej 30 % dhe kur shumës prej 3.870 € i zbritet 30 % e përgjegjësisë për të paditurën e dytë, ka rezultuar se detyrimi i të paditurës së parë ndaj paditësit është në shumë prej 2.709.00 €, të cilën shumë paditësi e ka kërkuar me kamatë ligjore duke filluar nga data e ekspertizës për vlerësimin e dëmit.

Nga ana e të paditurës është kontestuar pjesërisht baza e kërkesë padisë, mirëpo e ka kontestuar ndarjen e përgjegjësisë, me kërkesën se kjo ndarje është më e ulët, ndërsa nga lartësia e dëmit nuk është zbritur amortizimi i automjetit për vitet e kaluara. Ndaj të paditurës së dytë padia është tërhequr për mungesë të legjitimacionit.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka konkluduar se, në rastin konkret kërkesëpafia e paditësit është e bazuar, lidhur me këtë ka siguruar prezencën e ekspertit të komunikacionit dhe të makinerisë, lidhur me rastin e aksidentit të komunikacionit, në të cilin aksident paditësi ka pësuar dëm material në automjetin e tij Suzuki me targë të regjistrimit 405-KS-434, i cili dëm është në shumë prej 3.870 € ku e paditura e dytë për përgjegjësin 70 % duhet të paguaj paditësit shumën prej 2.709 €.

Sipas ekspertit të komunikacionit Y.K. është konstatuar se shkaktar kryesor i këtij aksidenti është shpejtësia e madhe dhe e pa lejuar e veturës “Audi” të cilën e ka drejtuar i siguruari i të paditurës KS “Insig”, ndërsa aksidentit i ka kontribuar edhe paraqitja e veturës “Pikapi” tani për tani e pa identifikuar, ku përgjegjësin e mban e paditura e dytë. Në këtë aksident paditësi ka pësuar dëm material në automjetin e tij dhe gjykata bazuar në ekspertizën e makinerisë, e ka detyruar të paditurën e parë që paditësit t'ia paguaj dëmin e pësuar bazuar në përgjegjësin e të paditurës së parë.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e neneve 154, 277 të LMD-së dhe nenit 323, 452.1, 453 dhe 449 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës parë drejtë ka vendosur kur kërkesëpadinë e paditësit, e ka aprovuar si të bazuar, me arsyetim se kërkesa e paditësit është e bazuar, sepse i njëjti duke qenë në cilësi të drejtuesit të automjetit të udhëtarëve “Suzuki”, me targa XYZ-KS-XYZ, dhe nga goditja e drejtpërdrejtë, ka pësuar dëmin material në automjetin e tij, lartësinë e të cilit e ka vlerësuar eksperti i makinerisë N.SH., Po ashtu, bazuar në përgjegjësinë e të paditurës në rastin konkret, e cila bazuar në ekspertizën e komunikacionit të cilën e ka punuar eksperti Y.K., ndërsa përgjegjësia e ndarë ka qenë për të paditurën 70 % dhe duke llogaritur këtë përgjegjësi nga shuma në lartësi prej 3.870 €, të cilën e ka llogaritur eksperti i makinerisë dhe kur kësaj i zbritet përgjegjësia të cilën e ka pasur e paditura e dytë në lartësi prej 30 %, atëherë shuma e mbetur për pagesë në emër të dëmit material të shkaktuar në automjetin e udhëtarëve të paditësit, është në lartësi prej 2.709.00 €, të cilën detyrohet që paditësit t’ia paguaj e paditura e parë KS “Insig”.

Gjithashtu, në këtë situatë të krijuar gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur në këtë shumë e ka detyruar të paditurën e parë që të paguaj edhe kamatën duke filluar nga data 26.04.2010, si datë kur është konstatuar lartësia e dëmit përkatësisht kur është kryer ekspertiza.

Prandaj, në këtë aspekt pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është e pa bazuar sepse, gjykata e shkallës së parë bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të tyre si dhe ekspertimet përkatëse për situatën e krijuar, duke vërtetuar në tërësi gjendjen faktike, ka nxjerr konkludimin e drejtë dhe të ligjshëm.

I pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm është edhe pretendimi ankimor i të paditurës, për përfshirje të aktgjykimit të atakuar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së, me arsyetim se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje të tilla, e as me shkelje të tjera për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Kështu që, aktgjykimi përmban dispozitiv të qartë, i cili është në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë si dhe i njëjti ka arsye të qarta mbi faktet vendimtare, të cilat e kanë shtye gjykatën e shkallës së parë për të vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, edhe ndarja e përgjegjësisë në mes të paditurave, të rastit konkret, sipas Gjykatës së Apelit, është reale dhe konform gjendjes së vërtetuar faktike lidhur me rastin konkret.

Ndërkaq, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, kur gjykata i referohet dispozitave ligjore të nenit 154 dhe 277 të LMD-së, përkatësisht nenit 323 të LPK-së, pra në dispozitatat përkatëse ligjore që i referohen çështjes së kompensimit të dëmit, të cilin e ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit të datës 04.03.2008.

Kështu që në këtë aspekt pretendimet ankimore të të paditurës janë të pa bazuara. Në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me dëmin material të shkaktuar në automjetin e paditësit, kështu që dispozitat tjera ligjore, janë të pa nevojshme që të aplikohen.

Me sa u tha më lartë, e meqë gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, dhe nuk ekzistojnë shkeljet esenciale për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së, në bazë të nenit 195 par.1 pika d) të LPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË
AC.nr. 4762/2014 me dt.06.09.2017

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Llulluni